



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 26.06.2019

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2018 PËR PROJEKTIN “PROGRAMI SEKTORIAL I UJËRAVE/ FURNIZIMI ME UJË I ZONAVE RURALE IV””

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 26.06.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2018 për projektin “Programi sektorial i ujërave/ furnizimi me ujë i zonave rurale IV””.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin z. Edmond Leka.

Në mbledhjen e komisionit, për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të komisionit, ishte i pranishëm z. Hantin Bonati, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i propozuar synon ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2018 për projektin “Programi sektorial i ujërave/ furnizimi me ujë i zonave rurale IV”.

Nëpërmjet kësaj marrëveshje bëhet i mundur financimi i programit “Ujësjetellësat Rurale IV”, në kuadër të të cilit parashikohet që nga Kfw-ja të akordohet për qeverinë shqiptare, ose një huamarrës tjetër, një kredi në vlerën 40 milionë euro dhe një grant në vlerën 2 milionë euro.

Shuma e akorduar për palën shqiptare do të përdoret për përmirësimin e infrastrukturës së ujësjetellësve dhe kanalizimeve, nëpërmjet sigurimit të qëndrueshëm në furnizimin me ujë të pijshëm për popullsinë rezidente dhe turistët në zonën që përfshin Bashkinë Himarë (qytetin e Himarës dhe fshatrat: Kuç, Buronjë (afër Kuç), Pilur, Kudhës, Vuno, Jalë, Livadhi, Himarë Fshat, Qeparo e Borsh), vënien në punë të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura të Orikumit, instalimin e lidhjeve familjare për ujësjetellësin në qytetin e Orikumit, me kosto sociale të pranueshme dhe tarifa që i mbulojnë kostot.

Përzgjedhja e kësaj zone është bazuar në thirrjet mbarëkombëtare për aplikime, në mënyrë që të identifikoheshin nevojat më urgjente për ndërhyrje. U identifikuan nevoja të konsiderueshme për investime në qytetin e Himarës dhe në fshatrat fqinje dhe Himara u propozua për t’u shqyrtuar më tej, pasi kjo bashki konsiderohet si një nga rajonet më të rëndësishme turistike në Shqipëri, me një potencial të madh për zhvillim të mëtejshëm.

Problematikat që hasen në zonën e Himarës janë të lidhura me faktin se ndërtimi i sistemeve të ujësjetellësve të saj datojnë që në vitin 1964. Sistemet ekzistuese të furnizimit me ujë janë në rrjete të vjetra, që shkaktojnë humbje të ujit në shkallë të madhe dhe puse me një kapacitet të pamjaftueshëm për kërkesën gjithmonë e në rritje, veçanërisht gjatë pikut të sezonit veror.

Zbatimi i këtij projekti do të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe do të promovojë zhvillimin e turizmit në zonën e projektit, duke e çuar numrin e përfituesve në 80 000, përfshirë turistët.

Përcaktimi përfundimtar se cilat do të jenë investimet në Himarë do t’i nënshtrohet studimit të fizibilitetit, të financuar nga qeveria Gjermane, studim i cili ka përfunduar në dhjetor 2018.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën kur Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë njofton qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është data e marrjes së njoftimit.

III. DISKUTIME DHE PROPOZIME NË KOMISION

Projektligji u prezantua nga z. Hantin Bonati, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, i cili sqaroi përpara anëtarëve të komisionit detajet e projektit për përmirësimin e infrastrukturës së ujësjellësve dhe kanalizimeve në Bashkinë e Himarës dhe zonën e Orikumit si dhe iu përgjigj pyetjeve të anëtarëve të komisionit lidhur me zbatimin e këtij projekti.

Lidhur me agjencinë e zbatimit të projektit, u propozua nga z. Fino që mbikëqyrja dhe menaxhimi i projektit të bëhet nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe jo Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Zoti Fino theksoi se Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime është i vetmi organ shtetëror i specializuar në fushën e furnizimit me ujë të pijshëm, kanalizimeve të ujërave të zëza dhe të bardha si dhe trajtimit të tyre (infrastrukturës ujore). Kjo agjenci mbështet teknikisht politikat e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe duhet të ketë cilësinë e agjencisë së zbatimit të projektit.

Propozimi i z. Fino u mbështet edhe nga anëtarë të tjerë të komisionit dhe u bë pjesë e këtij raporti për t'ia përcjellë Komisionit për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës.

IV. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATOR

EDMOND LEKA

KRYETAR

ULSI MANJA

